

Doktorata në Shkenca Ekonomike dhe Juridike synon t'u ofrojë kandidatëve për doktoratë një mjedis kërkimi të standardeve të larta. Kandidatët për doktoratë do të përqendrohen në zhvillimin e aftësive të tyre për të përballuar pyetje të reja, origjinale të kërkimit dhe për ti adresuar ato me mjete dhe metoda të azhornuara sasiore e cilësore. Qëllimi është të trajnojmë profesionistë me aftësi të larta dhe të kontribuojmë në përhapjen dhe përparimin e njohurive në ekonomi, biznes dhe qeverisje në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit privat e publik. Kjo do të mundësohet përmes një edukimi i cili bazohet në angazhimin e kandidatëve për doktoratë në kërkime gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, mentorimit të tyre nga stafi i njësive bazë, bashkëpunimit fakultet-student në kërkim dhe një perspektive të fortë multidisiplinare që u ofron studentëve thellësinë teorike dhe metodologjike të nevojshme për të realizuar kërkimin dhe realizimin e punimit (disertacionit).

Fushat dhe nënfushat përkatëse të studimit janë si më poshtë:

Shkencat ekonomike:

1. Kontabilitet
2. Taksim
3. Menaxhim, sipërmarrje dhe novacion
4. Marketing dhe sjellje konsumatore

Shkencat juridike:

1. Studime kushtetuese,
2. E drejta ndërkombëtare publike,
3. E drejta evropiane
4. E drejta Tregtare në Bashkimin Evropian
5. E drejtë Penale dhe Proçedure penale
6. Ligji penal dhe parimet e zbatimit te tij
7. Kriminologji & Penologji
8. Krimi ekonomiko-financiar

Objektivat e Programit:

- Të trajnojë kandidatët për doktoratë në perspektiva të shumëfishta disiplinore në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të analizojnë, krahasojnë dhe sintetizojnë në mënyrë kritike teoritë, perspektivat, konceptet dhe çështjet komplekse në Administrim Biznesi.
- Për të përmirësuar aftësinë e kandidatëve për doktoraturë për të integruar njohuritë dhe metodologjitë e kërkimit në fushën e biznesit, më konkretisht në fushat e organizimit, menaxhimit, politikave, zhvillimit, financave publike dhe menaxhimit financiar.
- T'u sigurojë kandidatëve për doktoratë aftësi rigoroze për të bërë kërkime mbi sfidat e botës reale në lidhje me biznesin.
- Të zhvillojë aftësitë komunikuese të kandidatët për doktoraturë që ata mund të përdorin në prezantimin e hulumtimit të tyre në konferenca dhe seminare akademike dhe në proçeset e botimit të kërkimit në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

Elementët e planit vjetor të programit të studimit të doktoratës bazuar në projektin kërkimor shkencor dhe zhvillimit të financiar të njësisë bazë.

a) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, bëhet sipas planit doctoral të miratuar nga njësia bazë përgjegjëse.

b) Koha e realizimit të veprimtarive të kombinuara, kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, bëhet sipas planit doctoral të miratuar nga njësia bazë.

Nr.	Aktivitetet	Programi 3-vjeçar	Programi 5-vjeçar
1	Seminare për teoritë bashkëkohore, debatet aktuale të fushës përkatëse të studimit	I	I
2	Takimi me doktorantët në lidhje me Pyetjen/et Kërkimore /Hipotezat	I	I
3	Takimi me doktorantët në lidhje me Literaturën	I	II
4	Takimi me doktorantët në lidhje me Problematikat, Modelin analitik, apo qasjet krahasuese që do të përdoren	II	III
5	Takimi me doktorantët në lidhje me Strukturën e disertacionit	II	III
6	Takimi me doktorantët në lidhje me Instrumentat e përdorur, vrojtimin, eksplorimin, mbledhjen e të dhënave	II	IV
7	Takimi me doktorantët në lidhje me Instrumentat e përdorur, vrojtimin, eksplorimin, mbledhjen e të dhënave; kualifikimin e të dhënave	II	IV
8	Takimi me doktorantët në lidhje me analizimin e të dhënave; testimin e modeleve të përdorur; Gjetjet e studimit	III	V
9	Takimi me doktorantët në lidhje me Përfundimet, Rekomandimet	III	V
10	Prezantimi në departament	III	V
11	Trajnime, Workshop-e	II, III	III, IV, V
12	Konferenca kombëtare, ndërkombetare, publikime në revista	II, III	III, IV, V
13	Angazhim në mësimdhënie	I, II, III	III, IV, V
14	Mbrojtja finale	III	V